



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS

THE UNION THE INDEPENDENT OF KOSOVO

UNIA NEZAVISNIH SIDIKATA KOSOVA

## Fjalë hyrëse

Të nderuar të pranishëm, zonja dhe zotërinj, të nderuar gazetar - përfaqësues të medieeve, mirë se keni ardhur në tryezën e organizuar nga BSPK dhe FESH me rastin e shënimit të ditës së “Një Majit” – ditës së punëtorëve, me temën: “Çka pas Një Majit”.

Shfrytëzoj rastin t’iu falënderoj për pjesëmarrje.

Meqë jemi në vigjilje të kësaj dite, shfrytëzoj rastin që t’iu uroj “Një Majin”, të gjithë sindikalistëve dhe punëtorëve kosovarë me dëshirë për një të ardhme më të mirë.

Në përkujtim të kësaj date, këtë herë kemi vendosur që ditën e “Një Majit” ta shënojmë me temën e cekur.

Dita e “Një Majit “ e njohur si “ Dita e Punëtorëve “, i referohet kujtimit të punëtorëve që synonin të drejtën e orarit të punës ”tetë orësh”.

Në kontekst të kësaj historie sindikale, edhe BSPK e ka historikun e vet.

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, si asociacion i punëtorëve, u themelua në periudhën e vlimeve të mëdha politike.

Takimi i parë i Këshillit Nismëtar u mbaj me 9 Prill të vitit 1990 në lokalet e Institutit të Fakultetit Ekonomik në Prishtinë, ndërsa takimi i dytë me 16 Prill të po atij viti, në sallën e konferencave të Institutit Albanologjik, me një pjesëmarrje shumë më të gjerë të veprimtarëve. Mirëpo në kontekst të këtyre datave, jehonën më të madhe e pati Kongresi i parë i këtij subjekti, i cili u mbajt me 30 qershor dhe 1 e 2 korrik të vitit 1990, në Sallën e Pallatit të Kulturës në Gjakovë.

Asokohe, zhvillimet politike ishin të atilla, sa që të drejtat e punëtorëve ishin vetëm një segment nga ato që po i kumbisnim.

Pas qershorit të vitit 1999, me ndryshimin e rrethanave politike në Kosovë, edhe qasja e veprimit sindikal filloi t’i përshtatet situatës së re, kështu, BSPK tani ka një pamje pothuajse krejtësisht tjetër krahasuar me periudhën e atëhershme.

Dita e Punës, ose Festa e Punëtorëve, përkujtohet më 1 Maj të çdo viti dhe synon ta kujtojë angazhimin e lëvizjeve sindikale dhe vështtrimin ekonomik-social të punëtorëve.

Përkundër organizimit të përvitshëm që ky manifestim të shënohet përmes protestës, këtë herë shënimin e kësaj dite do ta përkujtojmë me organizimin e tryezës me temën e përmendur.

Në përvjetorët e kësaj date, natyrshëm lind pyetja: “Çka pas Një majit“. Pra parashtrohet çështja të vazhdojmë me dialog apo të protestojmë. Mirëpo, në këtë kontekst s’duhet harruar faktin se edhe pas protestave përsëri duhet ulur në tryezë për të negociuar me partnerët në dialog.

Vlen për të theksuar se pos protestave të shpeshta të federatave sindikale që janë anëtare të kësaj konfederate dhe trysnisë së përbashkët sindikale, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, iu është dashur përsëri të

negocioj. Në këtë kuptim mund të thuhet se rreth 90% të kërkesave sindikale, BSPK i ka realizuar përmes dialogut.

Meqë "Një Maji" është një shënim përkujtues, andaj edhe BSPK me këtë rast do t'i përkujtoj dhe sublimoj rezultatet e arriturat, me qëllim që t'i parashtroj synimet e veta në përcaktimet e prioriteteve për të ardhmen.

Me këtë rast s'duhet harruar faktin se përkundër sfidave të shumta, BSPK në bilancin e saj të sukseseve për periudhën e kaluar mund t'i radhit rezultatet si vijon:

- Bashkëpunimi i ngushtë dhe aktiviteti intensiv me organizatat sindikale regjionale dhe ndërkombëtare,
- Zhvillimi i bisedave me Liderët Sindikal të nacionalitetit serb të Kosovës, me qëllim të integritetit të tyre në jetën sindikale të vendit.
- Pjesëmarrja në organizimin e tryezave dhe takimeve të shumta lidhur me sensibilizimin e të drejtës në punë dhe lirive sindikale,
- Zhblllokimi i pagesës së 20 % për ndërmarrjet që janë privatizuar,
- Implementimi i reformave organizative në BSPK sipas rekomandimeve të Sindikatës Botërore - ITUC ,
- Përgatitja e draft kontratës kolektive në nivel vendi dhe nënshkrimi i saj,
- Pjesëmarrja me sugjerime dhe propozime në hartimin e amendamenteve të Ligjit të punës,
- Sensibilizimi dhe avokimi te grupet parlamentare për aprovimin e Ligjit të punës në Kuvendin e Kosovës,
- Bashkëpunimi me inspektoratin e punës me qëllim të implementimit të Ligjit të punës dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me ngritjen e standardeve në punë,
- Sensibilizimi dhe negociimi lidhur me ngritjen e pagave për punëtorët që financohen nga buxheti i Kosovës, dhe
- Angazhimi në funksionalizimin e Këshillit Ekonomiko Social.

Përpos rezultateve të cekura, në regjistrin e sukseseve BSPK mund t'i radhis edhe aprovimet e ligjeve si më poshtë:

- Ligji për Organizimin Sindikal në Kosovë,
- Ligji për Grevat në Kosovë,
- Ligji për Këshillit ekonomik-social,
- Ligji për Siguri, Mbrojtje të Shëndetit të të punësuarve dhe Ambientit të Punës,
- Ligji për Sigurimet Shëndetësore dhe
- Ligji për Pensionet.

Pos kësaj, BSPK është duke negociuar lidhur me përcaktimin e pagës minimale në nivelin vendi, me qëllim të ngritjes së standardit të jetesës së punëtorëve në territorin e Kosovës.

Duhet cekur se BSPK para vetes e ka një vizion të qartë edhe për të ardhmen duke vënë prioritete në aspiratat e parashtruara.

Për periudhën e ardhshme, BSPK ka parashtruar për synim prioritetet si vijon:

- Të mbetet avokat i përhershëm dhe mbrojtës i denjë i të drejtave të punëtorëve të anëtarësuar në këtë subjekt sindikal,
- Të dialogoj te partnerët në bisedime, për standardizimin dhe kategorizimin e

pagave të punëtorëve, pas përcaktimit të pagës minimale.

- Të dialogoj për një standard modest të jetesës së punëtorëve, të përafërt me atë në rajon.
- Të dialogoj pranë qeverisë për njohjen e stazhit të punës për periudhën: 1990 – 1999.
- Të dialogoj pranë qeverisë për krijimin e një fondi social për punëtorët e larguar nga puna për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve në të cilat kanë punuar me herët.
- Të dialogoj dhe sensibilizoj luftimin e ekonomisë informate.

Veç realizimit dhe synimeve të lartë cekura, BSPK do të angazhohet për rumbullakimin e infrastrukturës ligjore, si vijon :

- Ligji për pagën minimale,
- Ligji për ndërmjetësim me rastin e punësimit dhe të drejtës gjatë kohës së papunësisë,
- Ligji për luftimin e diskriminimit,
- Ligji për sigurimin e kërkesave të punëtorëve në rastet kur falimenton punëdhënësi.

Pos të përmendurave, BSPK pretendon të krijoj një organizim efikas, transparent dhe të qëndrueshme i cili kishte me qenë në shërbim të punëtorit, më sa vijon :

- Për vende pune me frymë sigurie,
- Për punë të ndershme, pagë dinjitoze,
- Për luftimin e punës në të zezë,
- Për të drejtën sociale dhe mbrojtjen sociale,
- Për të drejtën e barabarësisë së nacionaliteteve dhe komuniteteve,
- Për të drejtën e barabarësisë gjinore,
- Për forcimin e solidaritetit në mes të punëtorëve,
- Për forcimin e unitetit në mes të punëtorëve,
- Për solidarizim në mes të gjeneratave,
- Për të drejtën e arsimit kualitativ dhe aftësimin permanent,
- Për të drejtën në informim,
- Për të drejtën në bashkë-vendimmarrje edhe të punëtorëve,
- Për shoqëri pluraliste dhe tolerante,
- Për zhvillimin demokratik të vendit dhe veprim të lirë sindikal.

Faleminderit për vëmendje

Prishtinë, 1. Maj 2014

BSPK  
Haxhi Arifi - Kryetar